

VENDIM
Nr.708, datë 24.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
REALIZIMIT TË PROJEKTIT “DEKORI I 100 – VJETORIT TË PAVARËSISË SË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “projekte”, artikulli 604, t’i shtohet fondi prej 48 456 224 (dyzet e tetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e katër) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të projektit “Dekori i 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha